



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 569 Akti

Nr. 600 Vendimi
Tiranë, më 19.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues nr.1 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 15.12.2022, në orën 12:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Robert Kote**, prokuror në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pranishëm në seancën dëgjimore.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E”, të Aneksit të Kushtetutës; Ligji nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr.49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore, analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Robert Kote është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të tij si prokuror. Bazuar në pikën 4 të nenit 4 dhe në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr.1.

2. Në vijim të procesit të rivlerësimit, anëtarët deklaruan lidhur me konfliktin e interesit e më tej caktuan kryesues z. Lulzim Hamitaj. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë çështje është caktuar z. Gerrit Sprenger.

3. Gjatë procesit, subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e trupit gjykues.

4. Nga relatori janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

5. Në bazë të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike, si dhe janë mbledhur nga Komisioni informacione të nevojshme për hetimin sipas nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilave trupi gjykues ka vendosur mbi rezultatet e hetimit për subjektin rivlerësues.

6. Në datën 14.11.2022, trupi gjykues vendosi: (a) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit Robert Kote, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (b) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, si dhe ta ftojë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (c) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime dhe dokumentacion provues lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit, të cilat u administruan nga trupi gjykues për t'u vlerësuar në raport me vendimmarrjen përfundimtare.

II. SEANCA DËGJIMORE

8. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit Robert Kote në seancë dëgjimore, në datën 15.12.2022, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 15.12.2022, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

9. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit ishte prezent dhe u mbrojt vetë. Ai paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit dhe barrën e provës. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për z. Robert Kote në seancën e datës 19.12.2022, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte prezent gjithashtu.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI

11. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacionin e përditësuar lidhur me subjektin e rivlerësimit nga institucionet ligjzbatuese;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, së bashku me materialin shoqërues;
- d) dokumentet shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;

- dh) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik dhe dokumentacionin provues shoqërues;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht dhe dokumentacionin provues shoqërues;
- ë) denoncimet nga publiku dhe dokumentacionin për verifikimin e tyre, të mbledhur gjatë hetimit;
- f) shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit të dhëna gjatë seancës dëgjimore.

A. VLERËSIMI I PASURISË

12. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë e vlerësuara si më poshtë vijon.

13. Pasuria apartament me sipërfaqe 93 m², blerë në vlerën 4.000.000 (katër milionë) lekë, në rrugën “*”, pallati “***”, kati ***, ap. ***.** Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: kredi bankare me Kontratë Huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.5.1999, me Bankën e Kursimeve.

13.1 Subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën fillestare në vitin 2003 apartament me strukturë 2+1, sipërfaqe 93 m², me vendndodhje në Rrugën ***, pallati ***, blerë në vlerën 4.400.000 (katër milionë e katërqind mijë) lekë, me burim krijimi kredinë bankare dhe kursimet familjare.

13.2 Raiffeisen Bank (ish-Banka e Kursimeve) ka vënë në dispozicion dokumentacionin, nga i cili ka rezultuar se:

- Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në datën 2.8.1999 kërkesë pranë Bankës së Kursimeve për trajtimin me kredi për strehim, si i pastrehë, për shumën 4.000.000 (katër milionë) lekë, në zbatim të Vendimit¹ Nr. 102, datë 5.3.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, i ndryshuar.

- Me vendimin nr.***, datë 10.8.1999, të degës së Bankës së Kursimeve Tiranë, është miratuar kredia në favor të subjektit të rivlerësimit në shumën 4.000.000 (katër milionë) lekë, me objekt “blerje banese”. Në datën 12.8.1999, subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshorten D. K. ka lidhur me degën e Bankës së Kursimeve Tiranë Kontratën e Hipotekimit nr. *** rep., nr. ***, kol., datë 12.8.1999.

- Në të njëjtën datë midis këtyre palëve është lidhur Kontrata e Huas nr. *** rep., nr. *** kol., “Për blerje shtëpie”, sipas së cilës kredia do të lëvrohej disa ditë pas nënshkrimit, si dhe pas vendosjes së garancisë reale hipotekore në favor të huadhënësit.

13.3 Raiffeisen Bank informon Komisionin² se në bazë të kontratës së hipotekimit është vendosur hipotekë për kredinë e përfituar, pasuria e regjistruar në Regjistrin Hipotekor nr. ***, datë 11.8.1999, e cila është apartamenti në pronësi të shtetasit Robert Kote, i regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me numër regjistri inskriptimi nr. ***, datë 13.8.1999, në favor të Bankës së Kursimeve sh.a. (sot Raiffeisen Bank).

13.4 Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Raiffeisen Bank rezultoi: a) me urdhërshkrimin e brendshëm nr. ***, datë 16.8.1999, të Bankës së Kursimeve, është kaluar nga subjekti i rivlerësimit për llogari të shoqërisë “****” shuma prej 4.000.000 (katër milionë) lekësh me përshkrimin “kredi sipas vendimit të Komitetit të Kredisë nr.***, datë 10.8.1999”; b) me mandatarëtimin nr.*** të Bankës së Kursimeve, subjekti i rivlerësimit ka derdhur **shumën 415.600** (katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë për llogari të shoqërisë “***”.

¹Aktualisht i shfuqizuar/zëvendësuar me akte të mëvonshme.

²Shkresë nr. *** prot., datë 15.9.2020; shkresë nr. *** prot., datë 22.9.2022.

13.5 Në analizën financiare për këtë pasuri janë marrë në konsideratë edhe të ardhurat e dokumentuara³ të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, ku rezultojnë me të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

13.6 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri konstatohet se: a) Subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën *Vetting*, ku ka deklaruar çmimin 4.000.000 (katër milionë) lekë me burim krijimi kredinë, e cila, sipas deklaramit periodik të vitit 2003 dhe dokumentacionit të administruar, rezulton të jetë në shumën 4.415.000 (katër milionë e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë. b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pjesën takuese të pronësisë në pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 61 m² në qytetin e Gjirokastrës.

13.7 Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit lidhur me këto konstatime, i cili ka shpjeguar në vijim të rezultateve të hetimit se në procesverbalin e mbajtur në datën 18 shkurt 2016 nga inspektori i ILDKPKI-së, ka vendosur në dispozicion si kopjen e Kontratës së Shitblerjes me Kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.8.1999, po ashtu edhe Kontratën e Huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.5.1999. Në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* nuk e ka disponuar kontratën e shitblerjes, prandaj ka bërë edhe këtë pasaktësi. Subjekti i rivlerësimit e konsideron pasaktësi edhe mungesën e deklaramit prej tij në deklaratën *Vetting* të pjesës takuese të pronësisë në pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 61 m² në qytetin e Gjirokastrës (shtëpia e prindërve).

13.8 Këto pasaktësi të subjektit janë konsideruar të paqëllimshme nga trupi gjykues, për sa kohë që ato as nuk shoqërohen me pamundësi financiare dhe as nuk kanë pasur për qëllim pengimin e Komisionit për kryerjen e procedurave të rivlerësimit në mënyrë korrekte dhe të plotë.

14. Kontratë Kredie në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, në “Credins Bank”, marrë në vitin 2016, të cilën subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

14.1 “Credins Bank” ka vënë në dispozicion⁴ të Komisionit të dhënat dhe lëvizjet në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit. Nga dokumentacioni rezulton se në datën 20.3.2016 është paraqitur kërkesa e subjektit të rivlerësimit për trajtimin me kredi në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë me qëllim shlyerje detyrimesh.

14.2 Në datën 30.3.2016 është nënshkruar kontrata e kredisë konsumatore afatmesme dhe në të njëjtën datë është disbursuar vlera e kredisë prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh në llogarinë bankare të subjektit.

14.3 Nga lëvizjet në llogarinë bankare rezulton se nga ana e subjektit është tërhequr *cash* në datën 31.3.2016 shuma 380.000 (treqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

14.4 Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se qëllimi i përdorimit të kredisë së marrë në datën 30.3.2016, në “Credins Bank” dhe tërhequr në datën 31.3.2016, është për arsye të përballimit të shpenzimeve të qëndrimit të vajzës S. K. në Vienë. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur pyetësorit, ndër të tjera, si dokumentacion provues vërtetimin nr. *** prot., datë 8.9.2020, të shoqërisë “AK INVEST”, mbi transaksionet monetare të kryera nëpërmjet MoneyGram-it.

14.5 Deklarimet e subjektit përputhen me veprimet e kryera dhe të dokumentuara.

15. Llogari në lekë në “Credins Bank”, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, e cila në datën 5.12.2016 është financuar me *overdraft* në shumën 270.000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë. Subjekti ka deklaruar balancë debitore në shumën - 272.109 (dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e nëntë) lekë.

15.1 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga banka.

³Vërtetimeve nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Prokuroria e Përgjithshme dhe vërtetim për pagën e bashkëshortes të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë.

⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.6.2022.

16. Pasuria automjet tip “**”, të cilën subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2011, si dhe blerjen e saj në shumën 1.500 (njëmijë e pesëqind) euro.**

16.1 DPSHTRR-ja ka përcjellë⁵ për Komisionin dosjen e automjetit me targa *** dhe nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezultoi se automjeti tip “****”, vit prodhimi 1999, me targa ***, ka ardhur nga Mbretëria e Bashkuar në datën 9.4.2008, me palë shitëse shtetasin E. I. Me Kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.1.2012, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “****” kundrejt çmimit 1.000 (njëmijë) euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Sipas vërtetimit të zhdoganimit të këtij automjeti rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer zhdoganimin në datën 30.1.2012 dhe ka paguar vlerën 36.121 (tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e një) lekë.

16.2 Në bazë të kursit të këmbimit të monedhës euro në lekë të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012, vlera e blerjes së automjetit nga subjekti i rivlerësimit është 139.720 (njëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë, shtuar edhe shpenzimet doganore në vlerën 36.121 (tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e një) lekë. Kjo shumë është përfshirë në analizën financiare të subjektit, e cila është përparësisht e njëjtë me atë të deklaruar prej tij.

16.3 Referuar dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja⁶, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar Kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.8.2014, me palë blerëse shtetasin E. N., kundrejt shumës 4.000 (katër mijë) euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

16.4 Në bazë të gërme “b” të pikës 5 të nenit 22 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, amortizimi i aktiveve të tjera të veprimtarisë, ku përfshihen edhe automjetet, është 20% në vit. Komisioni konstaton referuar deklarimeve të subjektit se, pavarësisht përdorimit për rreth 3 vjet të automjetit, çmimi i shitjes 4.000 (katër mijë) euro është disa herë më shtrenjtë se çmimi i blerjes. Duke ngritur dyshime për një çmim fiktiv, në analizën financiare të vitit 2014 nuk është konsideruar shuma 4.000 (katër mijë) euro si e ardhur.

16.5 Në përfundim, konstatohet se çmimi i shitjes së automjetit tip “****” shtetasit E. N. në vlerën 4.000 (katër mijë) euro pas 3 vjetësh, është disa herë më i lartë se çmimi i blerjes nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 1.000 (njëmijë) euro. Komisioni konstaton se nuk ka logjikë ekonomike fakti i shitjes së këtij automjeti me një çmim më të lartë se çmimi i blerjes, me gjithë konsumimin e tij (amortizimi i sendit), ndaj këto të ardhura nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare të Komisionit.

16.6 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij sqaron për Komisionin se nga biseda me shtetasin E. N. rezultoi se modelit të automjetit tip “****” (që subjekti i rivlerësimit dispononte) i përshtatej shumë mirë impianti i gazit dhe ky shtetas i propozoi subjektin që, nëse donte ta shiste, ai ishte i gatshëm të paguante çmimin 4.000 (katër mijë) euro. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se: *“Jam interesuar për çmimin dhe modelet e impianteve të gazit, por nga ana tjetër nga diskutimi me këtë shtetas i shpreha edhe ‘frikën’ nga përdorimi i një automjeti me benzinë+gaz (ky automjet përdorej edhe për familjen dhe kam qenë në dilemë gjatë kohës së përdorimit, të vendosja apo jo impiantin e gazit). Në momentin që më erdhi propozimi nga ky shtetas për blerjen e automjetit në shumën 4.000 (katër mijë) euro, unë nuk jam menduar gjatë dhe kam pranuar propozimin duke e shitur këtë automjet.*

*Në shkresën e administruar nga Komisioni për dosjen e automjetit me targa *** janë të gjitha dokumentet që provojnë se blerësi E. N., menjëherë pas blerjes, ka vendosur impiantin e gazit. Çmimi i vendosur në kontratë është çmimi i vërtetë i paguar nga blerësi dhe arkëtuar nga unë. Në ndryshimin e automjeteve gjatë gjithë periudhës së deklarimit nuk ka ndodhur ndonjëherë tjetër që unë të realizoj fitim nga shitja e automjeteve, pasi realisht nuk kam pasur asnjë nevojë apo arsye të vendos një çmim joreal për të justifikuar në rritje të ardhurat e familjes. Nuk kam*

⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.9.2022.

⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.9.2020.

shtuar pasuri apo të kem përballuar ndonjë shpenzim, që do të më duhej të justifikoja nga ana tjetër këto shuma në rritje të të ardhurave.

*Automjeti është shitur dhe kam arkëtuar vlerën prej 4.000 (katër mijë) euro, së bashku me kursimet që kam shtuar, kam blerë në datën 29.8.2014 automjetin tip “***” në shumën 1.000.000 (një milion) lekë”.*

16.7 Në vlerësim të rrethanave të rezultuara nga hetimi në raport dhe me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i gjen deklaratimet e subjektit se: *“Nuk kam pasur asnjë nevojë apo arsye të vendos një çmim joreal për të justifikuar në rritje të ardhurat e familjes, nuk kam shtuar pasuri apo të kem përballuar ndonjë shpenzim, që do të më duhej të justifikoja nga ana tjetër këto shuma në rritje të të ardhurave”, të vërteta e të besueshme, megjithatë, për efekt të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues ka vendosur të mos i marrë në konsideratë në analizën financiare të ardhurat shtesë nga shitja e këtij automjeti në vitin 2014.*

17. Pasuria automjet tip “*”,** me targa ***, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DPV-në e vitit 2014, blerë nga shoqëria “***” sh.p.k., në shumën 1.000.000 (një milion) lekë.

17.1 DPSHTRR-ja ka konfirmuar⁷ për Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi automjetin tip “***”, me targa ***, të regjistruar në pronësi në datën 4.9.2014. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se:

a) Sipas deklaratës doganore rezultojnë se në datën 8.8.2014 ka hyrë nëpërmjet Doganës Durrës automjeti tip “***”, viti i prodhimit 2006, me marrës shoqërinë “***” sh.p.k. dhe eksportues “***” s.r.l., Itali, sipas çmimit të blerjes 5.600 (pesë mijë e gjashtëqind) euro [ekuivalent 772.800 (shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekë]. Sipas kësaj deklarate rezultojnë se shpenzimet doganore janë llogaritur në vlerën 160.011 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëmbëdhjetë) lekë.

b) Me Kontratën e Shitjes datë 29.8.2014, pala shitëse, shoqëria “***” sh.p.k., ia shet automjetin tip “***” subjektit të rivlerësimit kundrejt vlerës 1.000.000 (një milion) lekë, shoqëruar me faturë tatimore shitjeje datë 29.8.2014.

c) Sipas Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.10.2016, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e palës shitëse ia shet automjetin tip “***” palës blerëse, shtetasit E. F. B., kundrejt vlerës 6.000 (gjashtë mijë) euro, shumë e cila është likuiduar nga palët jashtë zyrës noteriale.

17.2 Në DPV-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitje të automjetit tip “***” në shumën 4.500 (katër mijë e pesëqind) euro ose ekuivalent në shumën 608.715 (gjashtëqind e tetë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë.

17.3 Subjekti i rivlerësimit rezultojnë në pamundësi financiare me burime të ligjshme në shumën -783.737 (shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë) lekë për krijimin e kësaj pasurie në muajin gusht të vitit 2014. Në këtë analizë nuk është përfshirë si e ardhur shuma nga diferenca e çmimit të blerjes dhe shitjes së automjetit prej 4.000 (katër mijë) euro trajtuar më lart.

17.4 Në përfundim, konstatohet se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e pasurisë automjet tip “***” në shumën -783.737 (shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë) lekë në vitin 2014. Kjo situatë është reflektuar në analizën financiare të subjektit.

18. Pasuria automjet tip “*”,** e deklaruar në DPV-në e vitit 2016: *“Blerje në shumën 1.000.000 (një milion) lekë dhe shitje e autoveturës “***” në shumën 980.000 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, për mospërmbushje të detyrimeve financiare”.*

18.1 DPSHTRR-ja ka përcjellë⁸ për Komisionin dosjen e automjetit tip “***”, me targa *** dhe nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezultojnë se automjeti me targa ***, vit prodhimi

⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.9.2022; shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2022.

⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.9.2022.

2010, rezulton se është blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., në datën 31.5.2016, në shumën 6.800 (gjashtë mijë e tetëqind) euro. Ky automjet është zhdoganuar në datën 4.6.2016 nga shoqëria “****” sh.p.k. në vlerën 259.818 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

18.2 Rezulton se 25 ditë pas kryerjes së procedurës së zhdoganimit është nënshkruar Kontrata e Shitjes së Automjetit, datë 29.6.2016, me palë shitëse shoqërinë “****” dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit në vlerën 1.320.000 (një milion e treqind e njëzet mijë) lekë, si dhe është lëshuar fatura tatimore nr. ***.

18.3 Sipas Certifikatës së Pronësisë datë 30.6.2016, automjeti me targa *** është regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe është prerë TPL-ja vjetore në favor të tij.

18.4 Subjekti i rivlerësimit në cilësinë e shitësit ka nënshkruar Kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.7.2016, me shtetasin E. J., përfaqësues i shoqërisë “****”, në cilësinë e blerësit, kundrejt çmimit 980.000 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

18.5 Në përfundim, rezulton se ky veprim është kryer brenda vitit të deklarimit, pasi subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e tij, likuidimin e faturës përkatësisht, prandaj e ka kthyer këtë automjet tek shitësi i tij.

18.6 Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri.

19. Ambient shërbimi me sipërfaqe 68 m², në shumën 45.000 (dyzet e pesë mijë) euro, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit Kontratë Paraprake Shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.2.2017, konstatuar nga ILDKPKI-ja në raportin e vlerësimit.

19.1 Nga verifikimet e kryera, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2017 Kontratë Paraprake Shitje, por ka deklaruar marrjen e një kredie në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro.

19.2 Nga hetimet e kryera dhe dokumentacioni i administruar ka rezultuar:

a) DPPP-ja ka informuar⁹ Komisionin se nga të dhënat e disponuara kanë rezultuar raportime nga noteri M. D. për Kontratën Paraprake të Shitjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë 20.2.2017, me palë blerëse subjektin e rivlerësimit dhe palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k., në vlerën 45.000 (dyzet e pesë mijë) euro.

b) Nga noterja M. D. është vënë në dispozicion për Komisionin:

i) Kontrata Paraprake e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2017, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori E. L. dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit për blerjen e një njësie shërbimi me vlerë 45.000 (dyzet e pesë mijë) euro, e cila do të likuidohet me këste.

ii) Kontrata Paraprake e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.2.2017, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori E. L. dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit për blerjen e një njësie shërbimi me vlerë 45.000 (dyzet e pesë mijë) euro, me tekst të njëjtë me kontratën më sipër.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se kontratat noteriale të sipërcituara nuk janë raportuar në Zyrën e Regjistrimit Noterial^{10,11}.

c) Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga “ABI Bank”¹² rezulton se në datën 8.2.2017 është paraqitur kërkesa e subjektit për trajtimin me kredi në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro. Nga dokumentacioni i përcjellë nga banka ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka depozituar:

i) Kontratën Paraprake të Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.3.2017, të lidhur para noterit, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori E. L. dhe

⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.9.2020.

¹⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.9.2020.

¹¹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 28.9.2022.

¹²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 18.7.2022.

palë blerëse subjektin e rivlerësimit për blerjen e një njësie shërbimi nr. ***, me vlerë 45.000 (dyzet e pesë mijë) euro;

- ii) mandatarkëtimin nr. ***, me përfitues shoqërinë “****” sh.p.k. për pagesën *cash* nga subjekti të shumës 10.000 (dhjetë mijë) euro, në datën 20.2.2017, me qëllim blerjen e një njësie në rrugën “****”;
- iii) mandatarkëtimin nr. ***, me përfitues shoqërinë “****” sh.p.k. për pagesën *cash* nga subjekti të shumës 5.000 (pesë mijë) euro, në datën 24.2.2012, me qëllim blerjen e një njësie në rrugën “****”.

ç) Nga lëvizjet e llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në “ABI Bank” rezulton se në datën 23.3.2017 është disbursuar në llogari kredia në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro dhe në datën 24.3.2017 është transferuar shuma 29.446 (njëzet e nëntë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) euro, me përshkrimin “pagesë kësti 2, sipas Kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.3.2017, në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k”.

d) Sipas Kontratës së Huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.3.2017, lidhur me palën kredidhënëse “ABI Bank” dhe palën kredimarrëse subjektin e rivlerësimit, rezulton se kredia ka si qëllim blerjen objekt shërbimi në rrugën “****”, Tiranë, me afat shlyerjeje 11-vjeçar nga data e disbursimit. Kjo kredi vazhdon të likuidohet me këste çdo muaj.

dh) Sipas Kontratës së Hipotekës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.3.2017, pasuria e vendosur kolateral për kredinë me vlerë 30.000 (tridhjetë mijë) euro është njësi shërbimi me sipërfaqe 116 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në pronësi të shtetasve Y. G. dhe D. G.

19.3 Shoqëria “****” sh.p.k.¹³ ka informuar Komisionin se kontrata paraprake e shitjes me subjektin e rivlerësimit është revokuar me vullnet të plotë e të lirë të palëve dhe ambienti i shërbimit i është shitur shtetas H. D. Shoqëria “****” sh.p.k. ka përcjellë për Komisionin dokumentacionin si vijon: (a) Kontratë Paraprake Shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2017, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori E. L. dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit, me objekt “blerje e një ambienti shërbimi nr. ***, me sipërfaqe 68 m², në shumën 45.000 (dyzet e pesë mijë) euro”; (b) njoftim për revokim kontrate datë 27.4.2017 nga administratori i shoqërisë “****” sh.p.k. për prishjen e njëanshme të Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., “për shkak të mosshlyerjes së detyrimit dhe shitjes palës tjetër”; (c) revokim kontrate jonoteriale datë 27.4.2017, me deklarues subjektin e rivlerësimit dhe shoqërinë “****” sh.p.k., me administrator shtetasin E. L., për revokimin e Kontratës Paraprake të Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2017, për ambientin e shërbimit me sipërfaqe 68 m², ende i paregjistruar në ZVRPP. Revokimi i kontratës është nënshkruar nga shtetasi Sh. L. si deklarues i shoqërisë “****” sh.p.k. dhe deklarues subjekti i rivlerësimit; (ç) njoftim i lëshuar në datën 10.10.2017 nga shoqëria “****” sh.p.k., nënshkruar nga shtetasi Sh. L. me prokurë të posaçme, duke vendosur në dijeni të tërheqë të hollat e marra nga kredia në “ABI Bank”, pasi njësia e shërbimit i është shitur palës tjetër H. D.; (d) Kontratë Porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.11.2017 dhe Kontratë Shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2018, të noterizuara para noterit D. J. Gj. për blerjen e njësisë së shërbimit me sipërfaqe 68 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., përfaqësuar me Prokurën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.7.2014, nga shtetasi Sh. L. dhe palë porositëse shtetasen H. D.

19.4 Drejtoria Vendore ASHK Tirana Veri¹⁴ ka përcjellë për Komisionin dokumentacionin tekniko-ligjor për njësi shërbimi me sipërfaqe 68 m², nga e cila rezulton se pasuria me nr. *** është regjistruar për herë të parë me certifikatë pronësie në datën 10.2.2017, në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe në datën 5.2.2018 është regjistruar pronësia në emër të shtetas H. D. sipas Kontratës së Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2018.

¹³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2022.

¹⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.7.2022.

19.5 Nga verifikimi i të dhënave historike në ekstraktin e shoqërisë “****” sh.p.k. rezulton se në datën 17.7.2014 kjo shoqëri ka nënshkruar vendimin e asamblesë, sipas të cilit ortaku i vetëm, shtetasi E. L., vendos largimin e tij nga detyra si administrator dhe emërimin në detyrën e administratorit shtetasin R. L., si dhe kalimin 100% të kuotave të shoqërisë në favor të shtetasit R. L. nëpërmjet dhurimit.

Sipas ekstraktit historik të shoqërisë tregtare “****” sh.p.k. rezulton se prej muajit korrik 2014 e në vijim, administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë rezulton shtetasi R. L., i përfaqësuar me prokurë nga shtetasi Sh. L..

19.6 Nga verifikimi i të dhënave në internet ka rezultuar se shtetasi E. L. është ndaluar më 31.7.2017¹⁵, i dënuar me 1 vit e 4 muaj burgim për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁶ ka rezultuar se me vendimin nr. ***, datë 27.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur deklarimi fajtor dhe dënimi i shtetasit E. L. për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 22.9.2016, ka lënë në fuqi me disa ndryshime vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 10.5.2017, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

19.7 Lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorëve se nuk e ka blerë këtë pasuri, pasi kjo marrëveshje nuk është realizuar dhe ai nuk disponon një pasuri. Subjekti ndër të tjera, ka shpjeguar: *“Në vitin 2017 kam lidhur Kontratë Paraprake Shitjeje nr. *** me shoqërinë “****” sh.p.k. për blerjen e një ambienti shërbimi me sipërfaqe 68 m² në rrugën “****”. Pas marrjes së kredisë, diferencën prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro nuk e disponoja dhe i kisha kërkuar kunatit tim borxh për plotësimin e të gjithë vlerës së detyrimit duke më mundësuar blerjen dhe pagesën totale të këtij ambienti. Në kushtet kur prej tij nuk u arrit mundësia për të dhënë diferencën dhe nuk doja të merrja borxh diku tjetër, unë i kam paguar fillimisht shitësit vetëm vlerën prej 30.000 (tridhjetë mijë) euro. Shitësi më ka pritur pothuajse deri në fund të muajit prill për përmbushjen e detyrimit, në kushtet kur nuk arrita të siguroja diferencën e çmimit, të dyja palët, si unë dhe shitësi, kemi firmosur Kontratën e Revokimit që mban datën 27.4.2017. Në këtë mënyrë, të dyja palët u kthyen në gjendjen fillestare, unë duke hequr dorë nga blerja e këtij ambienti dhe shitësi duke më kthyer vlerën e paguar prej 30.000 (tridhjetë mijë) euro. Me shumën prej 30.000 (tridhjetë mijë) euro, të kthyer nga shitësi, kam kryer investim për rikonstruksionin e apartamentit, mobilim si dhe pajisje elektroshtëpiake, gjithsej rreth 14.000 (katërmëdhjetë mijë) euro [por asnjë shpenzim të veçantë më të lartë se 300.000 (treqind mijë) lekë] dhe pjesën tjetër e kam shpenzuar gjatë vitit për përbalimin e qëndrimit të vajzës dhe ia kam dhuruar motrës dhe vëllait, të cilët banojnë të dy në Greqi.*

*Për të qenë më i saktë me ju ... për këtë njësi shërbimi jam paraqitur para noterit publik për të lidhur një kontratë paraprake, e cila nuk është ekzekutuar asnjëherë, pasi brenda një kohe shumë të shkurtër ajo është anuluar nga vetë shoqëria për mospërmbushje të detyrimeve financiare nga ana ime. Arsyeja se përse është lidhur kjo kontratë paraprake me shtetasin E. L. ka të bëjë me faktin se në kohën kur është marrë Leja Zhvillimore e ndërtimit të objektit me nr. *** prot., datë 23.3.2014, miratuar me vendimin nr. *** prot., datë 29.1.2014, të Kryetarit të Bashkisë, ndodhur në rrugën ‘***’, kjo leje është marrë në emrin e shoqërisë ‘****’ sh.p.k. dhe në këtë kohë shoqëria ‘****’ me licencë ***, e regjistruar në Regjistrin Themeltar datë 3.9.2012, ka pasur drejtues ligjor E. L.. Në momentin e hartimit të kontratës paraprake të kësaj njësie shërbimi të ndodhur në këtë objekt, nga ana e firmës është paraqitur leja e zhvillimore, si dhe licën sa që përshkruam më lart. Në këto kushte, sipas noterit, detyrimin për të firmosur e kishte shtetasi E. L. Nga interesimi që kemi bërë në lidhje me kontratat për ambientet e këtij objekti ka rezultuar se në përgjithësi janë firmosur nga ky shtetas. Për sa i përket këtij shtetasi nuk kam asnjë njohje, nuk kam pasur asnjë kontakt përveç ditës që ai ka qenë para noterit dhe*

¹⁵ <http://www.panorama.com.al/>***

¹⁶Shihni shkresat nr. *** prot., datë 30.6.2022 dhe nr. *** prot., datë 14.7.2022.

atë ditë kam mësuar se ky ishte djali i të njohurit tim, shtetasit Sh. L., i cili në dijeninë time njihej si pronar i mirëfilltë i kësaj shoqërie.

Unë kam pasur njohje me babain e shtetasit E. L., z. Sh. L., i cili është në moshë më të madhe edhe se mua. Me shtetasin E. L. nuk kam pasur njohje, jam njohur vetëm në një nga rastet përpara noterit. Të gjitha marrëdhëniet dhe diskutimet për blerjen i kam pasur me shtetasin Sh. L. Fakti nëse ky shtetas gëzonte tagrin e përfaqësimit të shoqërisë “*** sh.p.k. është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e noterit publik dhe absolutisht jo imja, vetë ligji i noterisë e parashikon dhe detyron noterin në aktet që përpilon ... Për shtetasin E. L. nuk kam pasur ndonjëherë kontakt, përveç me babain e tij, me këtë shtetas kam diferencë të madhe në moshë dhe asnjëherë marrëdhënie njohjeje. Nuk kam pasur dijeni nëse ky shtetas ka qenë i proceduar, përveç momentit të informimit nga ana juaj.

Unë kam qenë në cilësinë e palës blerëse në këtë kontratë dhe nuk kam verifikuar nëse personi nënshkruar në kontratë kishte apo jo të drejtë firme.

Pasi jam vënë në dijeni nga ana juaj dhe jam konsultuar me ekstraktin e QKB-së, kam pyetur noterin. Kjo e fundit më informon se në dosjen e shoqërisë ka pasur dhe një autorizim për shtetasin E. L., të cilin po e paraqes të noterizuar. Filtri i kontrollit të kontratës së porosisë është kaluar edhe në departamentin ligjor të bankës, e cila më disbursoi kredinë. Nëse kjo kontratë është firmosur nga shtetasi E. L., kjo është përgjegjësi e noterit. Unë kam pasur njohje vetëm me shtetasin Sh. L., i cili më ka informuar se kontrata e porosisë është gati dhe jam paraqitur pranë noterit.

Mandati prej 10.000 (dhjetë mijë) euro është nënshkruar midis meje dhe shoqërisë për të plotësuar kushtin e marrjes së kredisë, pasi banka nuk disbursonte kredinë në rast të mosdokumentimit të likuidimit të kështit të parë. Për arsye se unë nuk arrita ta likuidoja kështin prej 10.000 (dhjetë mijë) euro, por nuk kisha mundësi të likuidoja edhe kështin tjetër prej 5.000 (pesë mijë) euro dhe nga ana tjetër shitësi kërkonte pagesën e tyre, kam anuluar përfundimisht kontratën e porosisë. Kontrata e anulimit ka qenë për t'u nënshkruar përpara noterit publik dhe unë i kam kërkuar shtetasit Sh. L. të paraqiteshim pranë zyrës së noterit, por nga juristja e shoqërisë ishte përgatitur kontrata e anulimit dhe gjatë diskutimit me të, më siguroi që nuk duhej me noter.

Për shkak se kontrata e porosisë i përket vitit 2017, jashtë periudhës së rivlerësimit, kam qenë subjekt kontrolli gjatë vitit 2021, për periudhën 2017 – 2020, nga ILDKPKI-ja. Në lidhje me kontratën e porosisë dhe disa momente të tjera jam penalizuar në shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë sipas vendimit nr. ***, datë 12.10.2021, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Në vendimin gjyqësor nr. ***, datë 17.6.2022, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesëpadinë time dhe ka shfuqizuar vendimin nr. ***, datë 12.10.2021.

Në vendimin e gjykatës trajtohet edhe momenti i anulimit të kontratës së porosisë, e cila është pranuar si provë”.

19.8 Subjekti ka bashkëlidhur si dokumentacion provues: (a) autorizim të lëshuar nga përfaqësuesi ligjor dhe administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., datë 24.2.2017, shtetasi R. L., i cili autorizon shtetasin E. L. të veprojë në emër dhe llogari të shoqërisë në zyra noterie, duke firmosur kontrata porosie me klientët. Ky autorizim është noterizuar nga noteri publik M. D. në formën vërtetim njësie me origjinalin nr. *** rep., datë 19.9.2022, me kërkues subjektin e rivlerësimit; (b) veprimet financiare të shoqërisë “*****” sh.p.k. me subjektin e rivlerësimit, shoqëruar me mandatpagesa dore për kthimin *cash* të shumës së kredisë; (c) vendimin nr. ***, datë 17.6.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, i cili shfuqizon vendimin e ILDKPKI-së për marrjen e masave administrative për shkelje të ligjit për deklarimin e interesave privatë.

19.9 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga subjekti i rivlerësimit ka rezultuar se kthimi i kredisë është kryer *cash*, në total 13 pagesa sipas mandatpagesave, ku pagesat e kthimit të kredisë fillojnë në datën 27.3.2017, në shumën 1.500 (njëmijë e pesëqind) euro.

19.10 Nga verifikimet nuk kanë rezultuar të dhëna për konflikt interesi të subjektit të rivlerësimit me shtetasin E. L.. Asnjë nga aktet e shqyrtuara për çështjen penale të trajtuar më sipër, nuk është trajtuar nga subjekti i rivlerësimit dhe as urdhra ndalimi apo aktezekutimesh për vendime gjyqësore.

19.11 Për sa më sipër ka rezultuar se:

a) Në vlerësim të tërësisë së veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe situatës së rezultuar nga hetimi, krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh, të cilat duket se kanë pasur për qëllim vetëm marrjen/përfitimim e kredisë bankare në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro.

b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka krijuar pasuri.

c) Objekti i porositur nga subjekti i rivlerësimit njësi shërbimi nr. 14, sipas kontratës paraprake të shitjes, përputhet me objektin e blerë e të paguar nga shtetasja H. D. dhe të regjistruar në hipotekë.

ç) Këto veprime janë kryer pas deklaratës *Vetting* dhe janë vlerësuar e trajtuar nga organi kompetent, ILDKPKI-ja.

19.12 Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar në seancë dëgjimore lidhur me këtë situatë, duke i qëndruar shpjegimeve të dhëna përgjatë hetimit administrativ dhe faktit se ai nuk ka krijuar asnjë pasuri me mjetet monetare të marra nëpërmjet kredisë bankare.

19.13 Duke qenë se kjo situatë nuk është brenda periudhës së rivlerësimit, ajo duhet t'i nënshtrohet kontrollit nga organet kompetente për vlerësimin e pasurisë, çka edhe ka ndodhur nëpërmjet kontrollit nga ILDKPKI-ja në vitin 2021, për të cilën subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 12.10.2021, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, ka marrë masën administrative përkatëse.

19.14 Trupi gjykues nuk gjeti asnjë rrethanë dyshuese që mund të lidhej me ndonjë pasuri të krijuar nga subjekti i rivlerësimit apo rrethana të tjera që mund të lidhen me periudhën e rivlerësimit objekt shqyrtimi nga Komisioni, si dhe nuk e gjen subjektin e rivlerësimit në asnjë nga rrethanat e nenit 33 pika 5, të Ligjit nr.84/2016.

20. Disa transferta për llogari të vajzës së subjektit S. K. në Vienë, Austri, të kryera në vitet 2014 – 2017, gjatë periudhës që ajo po kërkonte të fillonte studimet dhe kursin e gjuhës gjermane, të cilat subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar në pyetësonin standard të dërguar nga Komisioni.

20.1 Subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi shpenzime qëndrimi apo shkollimi për vajzën në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratat periodike vjetore për periudhën 2014 – 2016.

20.2 Gjatë hetimit administrativ, Shoqëria “AK INVEST” ka informuar Komisionin për disa pagesa të kryera me përfitues shtetasen S. K. në Austri, përkatësisht, në vitin: (a) 2016 në shumën 955 (nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) euro, kryer nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit; (b) 2017 në shumën totale 2.196 (dy mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) euro, kryer nga subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja e tij dhe motra e saj.

20.3 Nga veprimet bankare në llogarinë në monedhën euro të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank”, kanë rezultuar transferta ndërkombëtare, përkatësisht në vitin 2014 në shumën 830 (tetëqind e tridhjetë) euro me përshkrimin “pagesë qiraje” dhe në vitin 2015 në shumën 1.300 (njëmijë e treqind) euro me përshkrimin “pagesë shkolle”.

20.4 Në procesverbalin e mbajtur në datën 18.2.2016, pranë ILDKPKI-së¹⁷, subjekti i rivlerësimit është pyetur mbi pagesën në shumën 800 (tetëqind) euro, të kryer nga bashkëshortja D. K., më 10.12.2014, dhe në përgjigjen e dhënë ka shpjeguar si vijon: “*Në lidhje me pagesën e bërë nga bashkëshortja sqarohet se kjo pagesë është bërë për aplikimin për vazhdimin e studimeve të S. në universitetin publik të Vienës*”.

¹⁷Shihni përgjigjen me shkresën nr. *** prot., datë 4.5.2022.

20.5 Në vijim të hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit, i pyetur për këto shpenzime, ka deklaruar si vijon: *“Vajza ka aplikuar për të ndjekur programin bachelor në Shkenca Ekonomike në Universitetin e Ekonomisë dhe Biznesit të Vienës për vitin 2015 - 2016. Vajza ka shkuar në Vienë në datën 1.1.2015 dhe për qëndrimin ka paguar nga llogaria e bashkëshortes shumë 800 (tetëqind) euro, në datën 10.12.2014.*

*Ka qëndruar për disa kohë në apartamentin e marrë me qira dhe rreth muajit shkurt 2015 ka qëndruar në konviktin ***, ***, Str. ***, ***, Wien, me pagesë qiraje mujore 300 euro. Deri në muajin nëntor 2016 ka qëndruar në këtë konvikt gjatë gjithë kohës së qëndrimit në Vienë.*

Në vitin 2016 nuk vazhdoi më programin bachelor në universitet, por filloi kursin e gjuhës. Nuk disponojmë dokumentacion justifikues për pagesën e kursit të gjuhës, po nga sa më informon vajza, ka paguar rreth 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro tarifë (paguar në dy pjesë gjatë vitit 2016 dhe 2017). Gjatë vitit 2016 nuk e rinovoi lejen e qëndrimit si studente dhe ka përdorur të drejtën e qëndrimit për ndjekjen e kursit dhe mësimin e gjuhës.

*Në muajin nëntor 2016 deri kur është kthyer përfundimisht në korrik 2017 ka qëndruar në apartamentin e marrë me qira me adresë ‘***, Str. ***, ***, Vien’. Pagesa mujore për këtë apartament ka qenë rreth 700 (shtatëqind) euro në muaj, përfshirë edhe shpenzimet utilitare. Qëndrimi ka qenë për dy persona dhe kostot përballoheshin në mënyrë të barabartë midis tyre. Kur është kthyer në Shqipëri në vitin 2017, ka filluar studimet në ***, në degën Economics”.*

20.6 Subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion për të vërtetuar akomodimin e vajzës S. K. për periudhën shkurt 2015 - tetor 2016, në konviktin ***, me pagesë qiraje 300 (treqind) euro/muaj. Lidhur me shpenzimet e qëndrimit të vajzës për periudhën nëntor 2016 - prill 2017, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur në përgjigjet e pyetësorit nr.3: (a) kontratë përdorimi konvikti; (b) faturë për muajin prill 2017 në vlerën 688 (gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë) euro për muajin prill, ku përfshihen shpenzime qiraje së bashku me shpenzimet e utiliteteve.

20.7 Sipas databasës së Eurostat-it¹⁸, rezulton se shpenzimet vjetore të jetesës për një person në Austri për vitin 2015 janë mesatarisht në shumë 13.956 (trembëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë) euro [1.163 (njëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) euro/muaj] dhe për vitin 2016 janë mesatarisht në shumë 14.217 (katërmëdhjetë mijë e dyqind e shtatëmbëdhjetë) euro [1.184 (njëmijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) euro/muaj]. Komisioni ka llogaritur në analizën financiare shpenzime jetese për vajzën për periudhën e qëndrimit në Austri (11 muaj) sipas të dhënave të Eurostat-it.

20.8 Në përfundim konstatohet se:

a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* shpenzimet e kryera për shkollimin dhe jetesën e vajzës në Vienë, si dhe nuk i ka deklaruar ato as në deklaratimet periodike vjetore.

b) Subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare në fund të vitit 2015 në shumë -1.606.763 (një milion e gjashtëqind e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë dhe në vitin 2016 në shumë -661.813 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e njëmijë e tetëqind e trembëdhjetë) lekë, për pagesën e shpenzimeve të vajzës së tij, të dhëna që janë referuar në analizën financiare të Komisionit.

20.9 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

20.10 Në përgjigjen e tij mbi rezultatet e hetimit, subjekti ka shpjeguar se ditët e qëndrimit në Vienë nga vajza e tij nuk janë llogaritur nga Komisioni në raport të drejtë me situatën faktike (ditët reale të qëndrimit), duke kërkuar që Komisioni të llogarisë për periudhën 2015 – 2016, përkatësisht, 6 muaj qëndrim në vitin 2015 (dhe jo 11 muaj) dhe 5 muaj qëndrim në vitin 2016 (dhe jo 11 muaj).

¹⁸Eurostat - Data Explorer (europa.eu).

20.11 Subjekti, gjithashtu, ka kërkuar që llogaritja e shpenzimeve mesatare të jetesës të mos bëhej sipas të dhënave të EuroStat-it (siç është referuar Komisioni), pasi ato nuk pasqyrojnë standardin e jetesës për një student, por për një qytetar vjenez. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa dokumente lidhur me kostot e jetesës, të cilat i referohen qëndrimit të vajzës së tij në konvikt me kosto 302 (treqind e dy) euro/muaj (paraqitur korrespondencë me personelin e konviktit dhe kontratën përkatëse); deklaratë e shtetases E. B. (shoqe e vajzës) mbi qëndrimin në shtëpinë e saj për një periudhë të shkurtër, si dhe dokumentacion lidhur me mundësinë e kësaj shtetaseje për strehimin e S. në shtëpinë e saj; kontratë qiraje për një periudhë të shkurtër qëndrimi.

20.12 Lidhur me kostot e jetesës, përveç akomodimit/fjetjes, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shpenzimet kanë qenë deri në 450 (katërqind e pesëdhjetë) euro/muaj.

20.13 Trupi gjykues, pasi ka vlerësuar dokumentet e paraqitura nga subjekti lidhur me akomodimin e vajzës së tij dhe ditët e qëndrimit, i gjen ato të sakta dhe të vërteta, si dhe ditët e qëndrimit të pretenduara nga subjekti, në përputhje me të dhënat nga sistemi *TIMS*.

20.14 Lidhur me shpenzimet e jetesës, subjekti ka deklaruar se, përveç kostove të qëndrimit sipas dokumenteve të paraqitura, vajza e tij ka shpenzuar rreth 450 (katërqind e pesëdhjetë) euro/muaj, duke mos iu referuar një standardi, por gjithashtu duke kërkuar që ato të mos i referohen të dhënave sipas Eurostat-it, të përdorura nga Komisioni.

20.15 Trupi gjykues, në vlerësimin e tij, iu referua të dhënave në faqen zyrtare të Ambasadës¹⁹ Austriake, për shpenzime jetese për studentë nën 24 vjeç, që duan të studiojnë në Austri, të cilët, sipas të dhënave nga kjo faqe, duhet të përballojnë shpenzime qëndrimi/jetese në shumën 515 (pesëqind e pesëmbëdhjetë) euro/muaj. Këto të dhëna i referohen kostove/çmimeve për vitin 2019.

20.16 Trupi gjykues e gjeti me vend këtë arsyetim, duke e pranuar si metodë për llogaritjen e shpenzimeve, e cila vjen gjithashtu në harmoni edhe me pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerat e deklaruara si mbështetje/financim për vajzën e tij.

20.17 Trupi gjykues rishikoi analizën financiare për vitet 2015 – 2016, duke mbajtur në konsideratë kohëzgjatjen e qëndrimit të vajzës së subjektit të rivlerësimit dhe kostot e jetesës sipas standardit të parashikuar në faqen zyrtare të Ambasadës Austriake për studentë, për vitin 2019, nga e cila subjekti i rivlerësimit del me balancë negative në vlerën -133.127 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë në analizën financiare për vitin 2015 dhe në vitin 2016 rezulton me balancë pozitive për përballimin e shpenzimeve të shkollimit.

20.18 Lidhur me mosdeklarimet nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* të këtyre shpenzimeve, trupi gjykues vlerëson se gjatë hetimit administrativ gjenden gjurmë të pakontestueshme se këto shpenzime janë kryer si transferta bankare, pagesa nëpërmjet MoneyGram dhe se këto shpenzime janë deklaruar në pyetësorin standard të Komisionit që në fillimin e hetimeve, duke mos penguar hetimet për këtë veprimtari. Megjithëse pasaktësitë në deklarim mbeten, ato nuk mund të konsiderohen në kuadër të procesit të rivlerësimit, se plotësojnë ndonjë nga kushtet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, ato nuk të konsiderohen të tilla që mund të gjejnë zbatim.

21. Udhëtimet jashtë Shqipërisë

21.1 Subjekti i rivlerësimit deklaron në përgjigje të pyetësorit standard udhëtime me qëllim turizmi në qytetin e Korinthos, Greqi, për periudhën 2005 – 2016, për të cilat nuk detajon vlerën e shpenzuar. Ai deklaron: vendqëndrim në adresën e motrës, shtetases A. R., “*** 36, postcode *** ***”; vendqëndrim në adresën e nënës së tij, shtetases Dh. K. dhe vëllait të tij, shtetasit N. K. “79 *** *** *Korinthou*”; vendqëndrim në adresën e vëllait të bashkëshortes, shtetasit V. Sh. “*** ***/*Korinthos; Voreiou Ipeirou* 7, *** ***”. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur

¹⁹ <https://studyinaustria.at>

dokumentacion provues se ka qëndruar tek të afërmit e tij apo që ata jetojnë dhe kanë shtëpi në shtetin grek.

21.2 Nga kërkimi në sistemin *TIMS* rezulton se shtetasit A. R., Dh. K., N. K. dhe V. Sh. udhëtojnë drejt Greqisë nga pika kufitare Kakavijë, gjithashtu ata mund të kenë dokumente të tjera për udhëtim (p.sh.: dokumente greke).

21.3 Subjekti i rivlerësimit deklaron në përgjigje të pyetësorit standard dy udhëtime në Vienë të familjarëve të tij, me vendqëndrim në adresën e shtetasve M. dhe A. Sh., si miq të bashkëshortes, “*** ** WIEN AUSTRIA (Vienna)”. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues se ka qëndruar te këta shtetas apo që ata jetojnë dhe/ose kanë shtëpi në Vienë/Austri.

21.4 Nga kërkimi në sistemin *TIMS* rezulton se këta shtetas nuk kanë qenë në Shqipëri në këtë periudhë.

21.5 Komisioni deri në këto momente i ka llogaritur shpenzimet e udhëtimit, sipas sistemit *TIMS*, bazuar në vendimin nr. ***, datë 22.5.2019, të Kolegjit, duke marrë në konsideratë shpenzime qëndrimi me 5 euro/dita.

Në rast se nuk vihet në dispozicion dokumentacion provues lidhur me qëndrimin tek të afërmit, atëherë shpenzimet e qëndrimit do të llogariten sipas këtij vendimi, duke iu referuar shpenzimeve të qëndrimit në vlerën 50 (pesëdhjetë) euro/dita.

21.6 Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacion provues për të justifikuar shpjegimet/pretendimet e tij lidhur me udhëtimet dhe vendqëndrimet.

a) Në shpjegimet e tij subjekti ka paraqitur dokumentacion mbi familjarët e tij që jetojnë në Greqi (nëna, vëllai, motra dhe kunati), duke vënë në dispozicion dokumente qëndrimi (leje qëndrimi/kartë identiteti/pasaportë), të ardhura të tyre ndër vite, dokumentacion që provon adresat e banimit sipas deklaratave të subjektit të rivlerësimit mbi adresat e qëndrimit të tij në Greqi, si dhe deklaratatë të tyre se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë qëndruar tek ata gjatë ditëve të qëndrimit në Greqi.

b) Për shtetasit M. dhe A. Sh., miq të familjes, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion qëndrimi për këta shtetas në Vienë, si dhe dokumentacion lidhur me adresat e vendbanimit të tyre. Po ashtu, nga sistemi *TIMS* ka rezultuar se ata kanë qenë në Vienë gjatë periudhave të pretenduara/deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe deklaratatë të tyre se personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit kanë qëndruar tek ata gjatë vizitave në Vienë.

21.7 Trupi gjykues e ka gjetur këtë dokumentacion bindës dhe të pranueshëm, duke e marrë në konsideratë në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit.

22. Analiza financiare për periudhën e rivlerësimit

22.1 Bazuar në dokumentacionin e disponuar dhe deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni u krye analiza paraprake e treguesve financiarë.

22.2 Subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare me burime të ligjshme për periudhën 2014 – 2016 në shumën totale -2.656.858 (dy milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë për krijimin e pasurive dhe pagesën e shpenzimeve familjare vjetore. Kjo situatë negative financiare rezulton për shkak të shpenzimeve të shkollimit për vajzën e subjektit në Vienë, shpenzimet për blerjen e automjetit në vitin 2014 dhe shpenzimet për udhëtime.

22.3 Në vijim të shpjegimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur lidhur me analizën financiare disa qëndrime të ndryshme nga Komisioni sa i përket shpenzimeve të llogaritura. Konkretisht, subjekti ka kërkuar rishikimin e shpenzimeve për studimet e vajzës në Vienë, për periudhën 2015 - 2016, arsyetuar dhe pranuar më lart në vendim. Ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me qëndrimin e tij dhe familjarëve në Greqi pranë të afërmeve të tij dhe

qëndrimin në Vienë të vajzave dhe bashkëshortes në dy udhëtime, trajtuar dhe pranuar më lart në vendim.

22.4 Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar: rishikimin e shpenzimeve për një udhëtim në Londër të bërë prej tij në vitin 2015, për të cilin ka paraqitur dokumentacion provues se ka qenë udhëtim pune dhe është përballuar nga organizatorët; të merret në konsideratë vlera e plotë e shitjes së automjetit në vitin 2014, 4.000 (katër mijë) euro; të konsiderohen kursimet e tyre ndër vite (edhe pse të padeklaruara) si një mundësi për krijimin e pasurisë automjet në vitin 2014.

22.5 Trupi gjykues ka pranuar lidhur me shpenzimet dhe analizën financiare pothuajse të gjitha prapësimet e subjektit, duke mos pranuar vetëm shpenzimet lidhur me krijimin e pasurisë automjet në vitin 2014 nga përdorimi i gjendjes *cash* të padeklaruara dhe të ardhurat nga shitja e automjetit po atë vit.

22.6 Nga rishikimi i analizës financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare me vlerë -521.409 (pesëqind e njëzet e njëmijë e katërqind e nëntë) lekë për vitin 2014 - 2015 për përballimin e shpenzimeve familjare dhe investimeve të kryera prej tij dhe personave të lidhur.

22.7 Kjo situatë financiare nuk u konsiderua nga trupi gjykues e mjaftueshme për aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të pasurisë

23. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në konkluzionin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme. Trupi gjykues vlerëson se nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

23.1 Nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, trupi gjykues arriti në përfundimin se, pavarësisht pasaktësive në deklarimin e tij, subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues dhe ka informuar Komisionin lidhur me çdo kërkesë gjatë hetimit administrativ. Pasuria e vetme e subjektit të rivlerësimit është një apartament krijuar në vitin 1999, me burim të ardhura nga kredia bankare. Nga hetimi ka rezultuar se ai ka shpenzime dhe stil jetese modest dhe se situata negative financiare prej -521.409 (pesëqind e njëzet e njëmijë e katërqind e nëntë) lekësh për vitin 2014 - 2015 nuk duhet të përbëjë shkak për aplikimin e nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

24. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, DSIK ka dërguar në datën 2.11.2017 raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Robert Kote, i cili nuk përfshinte mendimin e njërit prej autoriteteve verifikuese.

25. Në vijim, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së rishikimin e raportit duke përfshirë edhe të dhënat e njërit prej autoriteteve verifikuese, përditësimin e informacionit/të të dhënave dhe deklasifikimin. DSIK ka dërguar në datën 28.10.2022 raportin e rishikuar për subjektin Robert Kote, të cilin e ka deklasifikuar pjesërisht. Në raportin e përditësuar, DSIK-ja informon Komisionin se: *“Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmërinë gjykojmë që në rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedura e hetimit administrativ që po kryeni ndaj subjektit të rivlerësimit”*.

26. Në vijim të verifikimeve mbi disa të dhëna konfidenciale, Komisioni ka kryer verifikimet e tij lidhur me *indicie* për një çështje penale të hetuar nga prokurori Robert Kote, duke vlerësuar të arsyeshme të verifikojë procedimin penal nr. ***.

26.1 Për këtë, i ka kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë informacion/dokumentacion mbi procedimin penal dhe kopje të vendimit, nga ku ka rezultuar si vijon:

- a) Në datën 22.12.2016 është kryer kapja në flagrancë e shtetasve K. T. dhe A. S. për veprën penale “mbajtje pa leje të municionit luftarak”, me qëllim transportin ose shitjen e tyre.
- b) Në datën 23.12.2016 është regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Tiranë procedimi penal nr. ***²⁰ mbi bazën e materialit procedural të përcjellë nga Komisariati i Policisë Nr. ***, Tiranë.

26.2 Nga rrethanat e ngjarjes rezulton se këta dy shtetas janë kapur në flagrancë nga policia me dy arka metalike me 1440 fishkë, *me qëllim transportin ose shitjen* e tyre dhe janë hetuar nën masën e sigurimit personal “detyrim paraqitjeje”.

26.3 Me vendimin datë 25.1.2017, prokurori i çështjes Robert Kote ka vendosur pushimin e hetimit të procedimit penal nr. ***, pasi ka konkluduar se personat nën hetim me veprimet e tyre aktive që konsistojnë në mbajtjen pa leje të municioneve, fishekëve, kanë kryer veprën penale “mbajtje pa leje të municioneve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, vepër kjo e kryer para datës 25.12.2016, e në rrethanat e hyrjes në fuqi të ligjit nr.141/2016, datë 22.12.2016, “Për dhënie amnistie”, vepra penale objekt akuze amnistohet dhe, për rrjedhojë, ndjekja penale për këtë vepër penale pushohet.

26.4 Në referim të dispozitave të ligjit nr.141/2016, “Për dhënie amnistie”, i cili ka hyrë në fuqi në datën 14.1.2017, përcaktohet se ndjekja penale pushohet për çështje nën hetim, si dhe për kallëzimet që ndodhen në këto organe për veprat penale të kryera deri më 25.12.2016, për të cilat parashikohet një dënim me burgim në maksimum deri në 2 vjet.

26.5 Në referim të dispozitave të nenit 278 të Kodit Penal “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, prokurori duket se ka bërë kualifikim të gabuar të veprës penale, duke e kualifikuar atë në nenin 278/2 të Kodit Penal, i cili parashikon: *“Mbajtja e municioneve luftarake pa lejen e organeve kompetente shtetërore përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet”*.

26.6 Nga vlerësimi i rrethanave duket sikur kjo vepër duhej kualifikuar sipas nenit 278/5 të Kodit Penal, i cili parashikon: *“Prodhimi, shitja, blerja, ofrimi për shitje, tregtimi dhe transportimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i armëve shpërthyes, pa lejen e organeve kompetente shtetërore dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet”*.

26.7 Në datën 22.12.2016 është kryer kapja në flagrancë e shtetasve K. T. dhe A. S. për veprën penale “mbajtje pa leje të municionit luftarak” dhe në datën 23.12.2016 është regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë procedimi penal mbi bazën e materialit procedural të përcjellë nga Komisariati i Policisë Nr. ***, Tiranë. Në datën 14.1.2017 ka hyrë në fuqi ligji nr. 141/2016, datë 22.12.2016, “Për dhënie amnistie” dhe në datën 25.1.2017 prokurori Robert Kote ka vendosur pushimin e hetimit të procedimit penal nr. ***.

26.8 Nga rrethanat e vërejtura, duket se prokurori Robert Kote nuk ka bërë një kualifikim të drejtë të veprës penale, e cila ka sjellë për pasojë pushimin e procedimit penal dhe shuarjen e masës së sigurisë, kthimin e automjetit dhe kalimin në favor të shtetit të municioneve luftarake (fishekë) të sekuestruar, për shkak edhe të ligjit për amnistinë.

28.8.1 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

26.9 Në vijim të shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit subjekti ka parashtruar: *“Nga rrethanat e ngjarjes rezulton se këta dy shtetas janë kapur në flagrancë nga policia me dy arka metalike*

²⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.10.2022.

me 1440 fishekë me qëllim transportin e tyre. Nga aktet e dosjes nuk rezulton se qëllimi i këtyre shtetasve apo ndonjërit prej tyre të ishte shitja e municionit.

Ndërkohë, dua të shpjegoj se në vitin 2016 vepra penale e parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal është ndryshuar tri herë. Fillimisht, sipas ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 135/2015, ndryshime të cilat hynë në fillim të vitit 2016. Më pas, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.9, datë 26.2.2016. ka vendosur: ‘Shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 55 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr. 144/2013, si dhe të paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr. 144/2013, ndryshuar me ligjin nr. 98/2014’ (ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 31, datë 29.2.2016). Më pas, neni 278 është riformuluar sipas ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 82/2016. Pra, në vitin 2016 vepra penale më e diskutueshme ka qenë neni 278 i Kodit Penal.

Çështja penale objekt i verifikimit të Komisionit është regjistruar dhe kualifikuar nga ana ime sipas vlerësimit dhe bindjes time të brendshme, si dhe ashtu siç ka referuar edhe policia gjyqësore.

Në momentin e regjistrimit kam çmuar se vepra penale e kryer nga shtetasit K. T. dhe A. S. duhej të kualifikohej sipas nenit 278/2 të Kodit Penal dhe jo sipas nenit 278/5 sepse në vlerësimin tim, për të kryer kualifikimin sipas figurës së veprës penale të parashikuar nga paragrafi i pestë i këtij neni, duhet të vërtetoheshin njëkohësisht se transportimi është kryer me qëllim tregtimi, fakt i cili nuk provohej nga aktet e ndodhura në dosje.

Në nenin 278/5 të Kodit Penal parashikohej: ‘Prodhimi, shitja, blerja, ofrimi për shitje, tregtimi dhe transportimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i armëve shpërthyes, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet’.

Pavarësisht sa më sipër, kualifikimi i veprës penale është kryer nga ana ime bazuar në bindjen time të brendshme dhe pa u ndikuar nga rrethana të tjera njëanshmërie. Në momentin e regjistrimit të kësaj çështjeje penale, neni 278 sapo ishte riformuluar dhe nuk ka pasur praktikë të konsoliduar për veprimin e kundërligjshëm të transportimit të municioneve. Para ndryshimeve të vitit 2016 në nenin 278 të Kodit Penal nuk parashikohej si formë e veçantë e anës objektive transportimi i municioneve (por vetëm prodhimi dhe mbajtja)”.

26.10 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se këto konstatime nuk mund të vlerësohen në kuadër të vlerësimit të figurës së subjektit të rivlerësimit, por ato mund të mbahen në konsideratë në vlerësimin tërësor të tij në kontekstin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

27. Gjatë hetimit të kryer për pasurinë ka rezultuar se sipas Kontratës së Hipotekës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.3.2017, pasuria e vendosur kolateral për kredinë e përfituar nga subjekti i rivlerësimit në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro është njësi shërbimi me sipërfaqe 116 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, në pronësi të shtetasve Y. G. dhe D. G.

27.1 Komisioni verifikoi pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për raste të mundshme të konfliktit të interesit me palë shtetasin Y. G. të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, për të cilën nuk rezultoi asnjë e dhënë²¹.

27.2 Sipas një të dhëne në internet²² rezulton se shtetasi me gjeneralitetet Y. G. është arrestuar në vitin 2018 për akuzën “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike”, kryer në bashkëpunim, si dhe përshtatjen e ambienteve për përdorim lëndësh narkotike.

27.3 Komisioni ka kërkuar informacion dhe dokumentacion nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë²³ për procedime/kallëzime penale me palë shtetasin Y. G., nga ku ka rezultoi:

a) procedimi penal nr. ***, viti 2019, në ngarkim të shtetasit Y. G., regjistruar për veprën penale “përshtatje e lokalit për përdorim droge”, për të cilën në përfundim të hetimit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka kërkuar në datën 24.10.2019 pushimin e hetimeve;

²¹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.10.2022.

²²<https://sot.com.al>***

²³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2022.

- b) kallëzimi penal nr. ***, viti 2022 për veprën penale “ndërtim pa leje”, sjellë për vlerësim, për të cilën është vendosur në datën 24.2.2022 mosfillimi;
- c) procedimi penal nr. ***, viti 2017, në ngarkim të shtetasit Y. G., regjistruar për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, nisur me kërkesë për gjykim në datën 31.12.2018.

27.4 Në procesverbalin e mbajtur në datën 27.5.2021, pranë ILDKPKI-së²⁴, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se lidhja me shtetasin Y. G. është miqësore dhe ka njohje prej 25 vitesh.

27.5 Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me konstatimet e rezultuara gjatë hetimit për shtetasin Y. G. si një kontakt i papërshtatshëm në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

27.6 Në vijim të shpjegimeve për rezultatet e ehtimit subjekti ka sqaruar Komisionin sa vijon: *“Me shtetasin Y. G. dhe bashkëshorten e tij familja ime ka pasur njohje prej 25 vitesh. Për shkak të kësaj lidhjeje me anë të Kontratës së Hipotekës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.3.2017, është vendosur kolateral për kredinë një pasuri në pronësi të shtetasve Y. G. dhe D. G.*

Me qëllim që t’i japë përgjigje kërkesës së Komisionit kam administruar nga gjykata vendimet e marra për këtë shtetas dhe rezulton se ai nuk është i dënuar.

*Me vendimin nr. ***, datë 31.10.2019, Gjykata ka vendosur ‘Pushimin e procedimit penal, të regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për hetimet e zhvilluara nga Prokuroria e Rrethit Tiranë ndaj shtetasit Y. G., regjistruar për veprën penale ‘përshtatje e lokalit për përdorim droge’. Si edhe me vendimin nr. *** akti, datë 26.2.2019 Gjykata ka vendosur ‘Pushimin e procedimit penal’ të regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për hetimet e zhvilluara nga Prokuroria Tiranë ndaj shtetasit Y. G. regjistruar për veprën penale ‘prodhim dhe shitje e narkotikëve’. Pra, nga aktet e administruara nga Komisioni, si edhe ato të paraqitura nga ana ime, rezulton se shtetasi Y. G. nuk është dënuar asnjëherë nga Gjykata dhe, si i tillë, ai nuk është person i përfshirë në krimin e organizuar. Në momentin e lidhjes së kontratës së hipotekës, jo vetëm unë, por edhe autoritetet ligjzbatuese nuk kanë pasur të dhëna për përfshirje të këtij shtetasi në ndonjë veprimtari të paligjshme.*

Në interpretimin të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, nuk konsiderohet për qëllime të këtij ligji ‘person i përfshirë në krimin e organizuar’, personi ndaj të cilit është vendosur nga gjykata pushimi i procedimit penal, me përjashtim të rastit të parashikuar në këtë nen, kur pushimi i procedimit penal është marrë sipas nenit 328/1, germa ‘ç’ e Kodit të Procedurës Penale, pasi i njëjti përjashtim është parashikuar edhe kur për subjektin është marrë vendim pafajësie bazuar në të njëjtin shkak. Pra fjalia e dytë barazon vendimin e pushimit të procedimit penal me vendimin e pafajësisë, duke përcaktuar se janë subjekte të përfshirë në krimin e organizuar edhe ata ndaj të cilëve është marrë vendim pushimi ose pafajësie për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet.

Pavarësisht kësaj bindjeje, theksoj se gjatë plotësimit të deklaratës Vetting dhe në momentin e lidhjes së kontratës së hipotekës nuk kam pasur asnjë dijeni për çështjet e këtij shtetasi në Prokurori”.

27.7 Në përfundim, trupi gjykues çmon se në një vlerësim tërësor të fakteve dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm, subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte me këtë shtetas, i cili, gjithashtu, ka vendosur në vitin 2017 një garanci pasurore si kolateral për një kredi bankare të marrë nga subjekti i rivlerësimit, por deri në këtë kohë nuk rezultuan të dhëna se ky shtetas të ketë qenë i akuzuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara nga ligji i posaçëm. Po ashtu, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë me cilësinë e prokurorit të çështjes në asnjë nga veprat penale të mëvonshme, për të cilat ai është akuzuar. Nga vlerësimi i akuzave konkrete ka rezultuar se në lokalit në pronësi të tij ishte konsumuar lëndë narkotike, por kjo

²⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2022.

vepër u pasua me pushimin e procedimit penal ndaj shtetasit Y. G., të regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin në gjyq të çështjes për të pandehurit e tjerë. Nga hetimi nuk ka rezultuar ndonjë nga rrethanat e parashikuara në nenin 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për më tepër që, nga shpjegimet e subjektit në raport me rrethanat e konstatuara krijohet bindja se ai, në mënyrë të besueshme, ka parashtruar faktet dhe rrethanat se nuk ka qenë në dijeni dhe madje as nuk beson se shtetasi Y. G. është një person i përfshirë në krimin e organizuar. Nuk rezultuan gjithashtu të dhëna për kontakte të vazhduara me këtë shtetas apo marrdhënie të tjera sipas parashikimeve ligjore. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka qenë i hapur, i besueshëm dhe i plotë në shpjegimet e tij për këtë shtetas.

27.8 Në përfundim, trupi gjykues çmon se ky kontakt ka lindur pas plotësimit të deklaratës *Vetting* dhe se nuk mund të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm për t'u deklaruar në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas mund të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të tij në kontekstin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzion për kriterin e kontrollit të figurës

28. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Robert Kote ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

29. Raporti i vlerësimit profesional është hartuar mbi bazën e raportit të vlerësimit të përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, lidhur me pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe tri dosjeve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së, si dhe të dhëna e *indicie* nga denoncimet lidhur me vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit.

30. Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurori Robert Kote, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të kryera nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës.

31. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

32. Për sa i përket vlerësimit në aspektin profesional, rezulton se ka shfaqur aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota.

33. Duke pasur parasysh statistikën e ngarkesës së punës, si dhe natyrën e çështjeve konstatohet se prokurori Robert Kote është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune, duke treguar eficiencë në marrjen e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm, referuar natyrës dhe shumëllojshmërisë së veprimeve hetimore. Afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse. Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti Robert Kote ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

34. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokuror Robert Kote, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

35. Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Robert Kote. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, në asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

D. DENONCIME

36. Në Komision janë paraqitur shtatë denoncime, tri prej tyre i përkasin të njëjtit denoncues dhe pesë prej tyre i drejtohen subjektit të rivlerësimit si prokuror i vetëm.

36.1 Denoncim i shtetasit V. Ç., i cili denoncon disa gjyqtarë dhe subjektin e rivlerësimit për korrupsion. Denoncuesi ankohet se prokurori Robert Kote në bashkëpunim me gjyqtarin A. V. i fshehën vendimin e arrestimit të djalit të tij, shtetasit V. Ç., duke ia komunikuar 6 muaj me vonesë.

Referuar akteve të vëna në dispozicion nga denoncuesi rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë prokurori i çështjes penale nr. *** ndaj shtetasit V. Ç., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Komisioni verifikoi pretendimin e denoncuesit, nga ku rezulton se ai është arrestuar në flagrancë dhe ndaj tij është vendosur fillimisht masa e sigurisë “arrest me burg” dhe më vonë është zëvendësuar në “detyrim paraqitjeje”.

Nga verifikimi i akteve nuk u evidentuan fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

36.2 Denoncim i shtetasit S. I., në të cilin denoncuesi ankohet se prokurori Robert Kote ka ngritur në ngarkim të tij akuzën për kryerjen e veprës penale “falsifikim dokumenti”, duke u mbështetur vetëm tek aktekspertimi grafik dhe nuk ka kryer asnjë verifikim.

Referuar akteve të denoncimit rezulton se shtetasi G. G. ka paraqitur kallëzim penal në Prokurori me pretendimin se Kontrata e Qirasë nr. *** rep., datë 12.4.1995, e lidhur ndërmjet shtetasit S. I. dhe Bashkimit të Sindikatave të Pavarura është e falsifikuar. Prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit S. I. për veprën penale “falsifikim dokumentesh” dhe, në përfundim të hetimeve, ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të këtij shtetasi. Në përfundim të hetimit gjyqësor prokurori i çështjes Robert Kote ka kërkuar deklarin fajtor të të pandehurit S. I. për veprën penale “falsifikim dokumentesh” dhe dënimin e tij me 1 vit burgim, në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal të vendoset në provë për një periudhë 2-vjeçare.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur me vendimin nr. ***, datë 27.10.2021, shpalljen fajtor të këtij shtetasi duke e dënuar me 1 vit burgim dhe në aplikim të nenit 59 pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe vënien në provë për një periudhë 2-vjeçare.

Komisioni vlerëson se pretendimet e denoncuesit i takojnë themelit të çështjes dhe duhet të trajtohen nga shkallët më të larta të gjyqimit. Nga verifikimi i akteve nuk u evidentuan fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

36.3 Denoncim i shtetasit A. D., në të cilin denoncuesi pretendon se prokurori Robert Kote ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehurit J. K. të akuzuar për kryerjen e veprës “përkrahje e autorit të krimit” dhe gjatë gjyqimit ka kërkuar ndryshimin e kualifikimit ligjor, duke e akuzuar për veprën penale “vrasje me paramendim”, mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim. Për denoncuesin, prokurori ka ndryshuar qëndrim mbi kualifikimin ligjor të veprës penale për shkak të pamundësisë së familjarëve të shtetasit J. K. për ta paguar.

Lidhur me këto të dhëna Komisioni kërkoi informacion dhe kopje dokumentacioni nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga informacionet e administruara rezultoi²⁵ se në datën 17.11.2017 është regjistruar procedimi penal nr. ***, në ngarkim të të pandehurve L. K. dhe J. K., të akuzuar për kryerjen e veprave penale “vrasje me paramendim”, mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “mbajtje pa leje e armëve luftarake”.

Në përfundim të veprimeve hetimore, në vitin 2019, prokurori Robert Kote ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehurit L. K. për veprën penale “vrasje me dashje” kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë dhe “armëmbajtje pa leje”, si dhe në ngarkim të të pandehurit J. K. për veprën penale “përkrahje e autorit të krimit”.

Në seancën paraprake të zhvilluar në datën 19.6.2020, gjyqtari E. B.²⁶ ka vendosur të pranojë kërkesën e prokurorit Robert Kote për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale në ngarkim të të pandehurit J. K. nga “përkrahje e autorit të krimit” në atë të “vrasje me dashje”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë si dhe kalimin e çështjes për gjykim.

Themeli i kësaj çështjeje është shqyrtuar nga trupi gjykues, i kryesuar nga gjyqtari A. K. dhe, në përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, me vendimin²⁷ nr. ***, datë 15.6.2021, është vendosur deklarimi fajtor i shtetasit L. K. dhe dënimi me 8 vjet burgim, si dhe deklarimi fajtor i të pandehurit J. K. dhe dënimi me 6 vjet burgim.

Nga përmbajtja e vendimit të gjykatës rezulton se trupi gjykues e ka gjetur të drejtë cilësimin ligjor të bërë nga Prokuroria dhe e gjen të pambështetur kërkesën e avokatit mbrojtës për ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës në ngarkim të të pandehurit J. K.

Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 7.3.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe ridërgimin e çështjes për gjykim me një trup tjetër. Në vendim është arsyetuar se deklarimi i dhënë nga shtetasi J. K. para policisë gjyqësore pa pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit, në praninë e mbrojtësit të caktuar kryesisht, është deklarim që ka prodhuar një provë të papërdorshme në kuptim të nenit 151, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale.

Nga të dhënat ka rezultuar gjithashtu se i pandehuri është gjykuar në mungesë në shkallën e parë dhe prokurori ka kërkuar gjatë gjykimit leximin e thënieve të tij, në cilësinë e personit nën hetim në fazën e hetimeve paraprake, ku rezulton se këto deklarime janë dhënë para organit të policisë gjyqësore, pa pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit.

Në përfundim, ndodhur në këto rrethana, ku gjykata ka konstatuar se vendimi i gjykatës është marrë në zbatim të gabuar të ligjit penal material dhe procedural dhe se e ka prishur atë duke e dërguar çështjen për rigjykim me një trup tjetër gjykues.

Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit, i cili shprehet se denoncimi i shtetasit A. D. është tendencioz, i pavërtetë dhe i palogjikshëm. Bazuar në ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Penale, sipas ligjit nr. 35/2017, veprimtaria e prokurorit përpara dërgimit të çështjes në gjykim kontrollohet nga gjyqtari i seancës paraprake. Bazuar në nenin 332/d, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, prokurori ka të drejtë të ndryshojë akuzën në seancë paraprake, kur fakti del ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për gjykim. Qëndrimi i prokurorit kontrollohet nga gjyqtari i seancës paraprake, i cili nëse do të kishte vlerësuar se cilësimi juridik përfundimtar i faktit është i gabuar ose kur akuza është formuluar në mënyrë të qartë mund ta kishte ftuar të bënte korrigjimet dhe saktësimet e nevojshme. Në rastin konkret, gjyqtari i seancës paraprake, sipas vendimit nr. *** akti, datë 19.6.2020²⁸, e ka gjetur drejt ndryshimin e akuzës së prokurorit nga “përkrahje e autorit të krimit” në “vrasje me dashje e mbetur në tentativë”, e kryer në bashkëpunim dhe e ka dërguar çështjen për gjykim. Më pas, çështja është dërguar për gjykim dhe një trupë gjyqësore e përbërë nga tre gjyqtarë ka

²⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2022.

²⁶Shihni linkun <https://abcnews.al/>***

²⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 19.10.2022.

²⁸Bashkëlidhur këtyre parashtrimeve.

mbështetur akuzën përfundimtare të prokurorit. Në këto kushte, subjekti vlerëson se faktet e parashtruara në këtë denoncim janë tërësisht të gabuara.

Në përfundim, Komisioni nuk gjeti shkaqe që mund të merren në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

36.4 Denoncim i shtetases M. B., e cila denoncon subjektin e rivlerësimit për korrupsion dhe moskryerje hetimesh. Denoncuesja pretendon se për kallëzimin e paraqitur prej saj prokurori Robert Kote nuk ka mbledhur dhe shqyrtuar të gjitha provat e depozituara. Sipas denoncueses, nga ana e prokurorit nuk janë kryer një sërë veprimesh verifikuese, duke mos u administruar në cilësinë e provës tabulate të bisedave telefonike, deklaratimet e OPGJ-së.

Lidhur me këto të dhëna, Komisioni kërkoi informacion dhe kopje dokumentacioni nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga përgjigjja rezultoi²⁹ se në datën 1.3.2021 është regjistruar kallëzimi penal nr. *** me palë kallëzuese shtetasen M. B.. Kjo shtetase ka pretenduar se prokurori B. B. ka kryer kallëzim të rremë në ngarkim të saj dhe OPGJ A. R. ka konsumuar veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim dokumentesh”. Denoncuesja ka pretenduar se në datën dhe orën e regjistrimit të kallëzimit të prokurorit B. B., ky i fundit ka qenë në ambientet e një lokali dhe jo në komisariatit e policisë, si dhe ka kërkuar administrimin e pamjeve filmike nga kamerat e sigurisë.

Çështja penale është hetuar nga prokurori Robert Kote, i cili në përfundim të veprimeve hetimore ka konkluduar se fakti i pretenduar nga kallëzuesja nuk përbën veprë penale dhe në referim të neneve 290 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur në datën 20.3.2021 për mosfillimin e procedimit penal.

Komisioni verifikoi pretendimet e denoncueses lidhur me veprimet hetimore të kryera nga prokurori Robert Kote, nga ku rezultoi se gjatë hetimit janë administruar si provë: deklarimi i OPGJ-së A. R.; dhe procesverbali për kallëzimin e veprës penale të prokurorit B. B.; dhe raporti i shërbimit lidhur me pamjet filmike të kamerave të sigurisë së lokalit.

Komisioni vlerëson se pretendimet e denoncuesit i takojnë themelit të çështjes dhe duhet të trajtohen nga shkallët më të larta të gjyqimit. Nga verifikimi i akteve nuk u evidentuan fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

36.5 Denoncim i shtetases E. K. (bashkim i tri denoncimeve), e cila denoncon subjektin e rivlerësimit për korrupsion, shkelje ligji dhe cenimin e besimit të publiku.

Referuar akteve të denoncimit rezulton se prokurori Robert Kote ka regjistruar në datën 17.7.2020 procedimin penal për veprën penale “falsifikim dokumenti” mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit S. V.. Prokurori ka kryer veprimet paraprake hetimore dhe ka kërkuar për t’u pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për ngjarjen, shtetasen L. K. Në përfundim të kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, nga ana e prokurorit është konkluduar në datën 28.10.2020 se familja e shtetasen L. K. nuk ka qenë subjekt përfitues i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, pasi kjo familje nuk ka qenë e regjistruar si banore në zyrën e gjendjes civile të komunës K. dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përfitonte tokë bujqësore në këtë komunë. Sipas prokurorit, Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi është i falsifikuar, pasi përmban të dhëna të rreme dhe nga ana e shtetasen L. K. janë konsumuar elemente të veprës penale “falsifikim dokumentesh” me rrethanat e përdorimit të këtij akti për regjistrimin e pronësisë në ZVRPP-në Tiranë, por në rrethanat kur nga koha e kryerjes së veprës penale deri në çastin e marrjes si të pandehur kanë kaluar 10 vjet, nuk mund të ushtrohet ndjekje penale.

Në vijim, me shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2020, Prokuroria e Rrethit Tiranë ka përcjellë kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga

²⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 29.9.2022.

gjyqtari A. A., i cili në përfundimi të gjykimit ka vendosur me vendimin nr. *** regjistri, datë 24.5.2021³⁰, mbi pranimin e kërkesës dhe pushimin e procedimit penal.

Kundër këtij vendimi është paraqitur ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit, i cili shprehet se pretendimet e denoncueses se gjatë hetimit janë kryer shkelje procedurale janë të pabazuara. Prokurori regjistron një çështje penale mbi bazën e akteve që përmban materiali kallëzues apo referues dhe për regjistrimin e veprës penale jo vetëm që nuk njofton të kallëzuarin, por sipas parashikimeve të nenit 279 të Kodit të Procedurës Penale hetimet janë sekret. Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar aktet dhe subjektet që duhet të njoftohen gjatë hetimit. Ashtu si vetë Komisioni konstaton se oficeri i policisë gjyqësore ka thirrur për të pyetur në lidhje me rrethanat e hetimit shtetasen L. K., e cila ka parashtruar edhe pretendimet e saj në seancë gjyqësore, pretendime të cilat gjykata nuk i ka gjetur të bazuara.

Kjo shtetase, përveçse ka bërë apel ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës parapake që ka miratuar kërkesën për pushimin e çështjes penale në Gjykatën e Apelit, ka paraqitur ankesë edhe në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe me shkresën nr. *** prot., datë 28.7.2021 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur arkivin e ankesës së paraqitur nga denoncuesja E. K., dokument të cilin subjekti e paraqet përpara Komisionit bashkëlidhur këtij observacioni. Në vendimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë arsyetohet se: *“Për sa i përket pretendimit për njëanshmëri, vlerësohet se ky pretendim është i pambështetur në të dhëna konkrete dhe nuk referon indicie për ekzistencën e një pretendimi të tillë”*.

Në përfundim, Komisioni nuk gjeti shkaqe që mund të merren në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

37. Në përfundim të vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë dhe është efektiv në punën e tij. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues të kërkuar nga neni 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin e aftësive profesionale.

38. Në një vlerësim tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që lidhet me problematikat e konstatuara gjatë vlerësimit të procedimit penal nr. *** nga prokurori Robert Kote si dhe kontaktin e tij me shtetasin Y. G., trupi gjykues i Komisionit çmon se veprimet e subjektit të rivlerësimit në mënyrën e interpretimit të çështjes në procedimin penal nr.*** kanë një logjikë në interpretimin e tyre lidhur me vetë problematikën e konstatuar në ndryshimet/interpretimin e nenit 278 të Kodit Penal dhe se qëndrimi i tij gjithashtu ka qenë në një linjë me qëndrimin e policisë gjyqësore që ka referuar veprën, e cila kishte bërë kapjen në flagrancë të autorëve. Pavarësisht se trupi gjykues çmon se qëndrimi i prokurorit vjen si pasojë e një hetimi të pathelluar dhe i një vlerësimi sipërfaqësor të fakteve që kanë rezultuar nga provat e administruara, duke vlerësuar se është bërë një zbatim i gabuar i dispozitës materiale për çështjen konkrete në gjykim, **çmon gjithashtu se ky vlerësim ka të bëjë me thelbin e zgjidhjes së çështjes dhe bindjen e prokurorit, ndaj nuk duhet të gjykohet e vlerësohet nga ky trup gjykues në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve³¹**. Trupi gjykues çmon se shkelja e kryer në rrethanat e lartpërmendura na çon në konkluzionin se ajo nuk mund të konsiderohen si shkelje haptazi dhe në kundërshtim flagrant me ligjin dhe, për pasojë, të kualifikohen si shkelje të rënda profesionale. Po ashtu trupi gjykues vlerëson se vetëm zgjidhja e kësaj çështjeje në këtë mënyrë, e vlerësuar në tërësinë e saj, në raport edhe me aktivitetin shumë të gjatë në sistem të këtij prokurori³², nuk mund të konsiderohet se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

³⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.10.2022.

³¹Vendimin nr. 17/2004 të Gjykatës Kushtetuese.

³² Emëruar në këtë funksion në vitin 1995.

Në vlerësim të kontaktit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin Y. G., trupi gjykues nuk gjen elemente apo rrethana për ta konstatuar këtë shtetas një person të përfshirë në krimin e organizuar, as marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas të tillë që cenon standardin e besueshmërisë së një prokurori. Në këtë konkluzion trupi gjykues ka arritur duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimet e konsoliduara nga jurisprudenca sipas të cilave, shkelja e rëndë etike, sipas përcaktimeve kushtetuese, duhet të jetë e një niveli që e bën prokurorin të padenjë për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë.

39. Nga vlerësimi tërësor i rrethanave që kanë rezultuar për subjektin rivlerësues, trupi gjykues në vlerësimin e cënimit të besimit të publikut, mban në konsideratë edhe rethanat e Nenit 148/d, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës së Shqipërisë ku parashikohet se: “1. Prokurori mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. 2. Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës; [...]”. Vlerësimi i vetëm një rasti, (parë ai edhe nga rëndësia, thelbi i çështjes dhe pasoja) nuk mund të jetë një standard i drejtë për të arritur në konkluzionin se ndaj subjektit të rivlerësimit mund të aplikohet neni 61/5 i ligjit nr. 84/2016. Po ashtu mardhënia e tij me shtetasin Y.G., nuk mund të përkufizohet si shkelje e rëndë etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës.

40. Në përfundim të sa më sipër, duke konstatuar se subjekti i rivlerësimit Robert Kote ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm të rrethanave të veçanta të çështjes, aplikimi i nenit 61/5 në mungesë të ndonjë treguesi për keqbesim ose shkelje të qëllimshme nga vetë aplikanti, vjen në disproporcion me qëllimet legjitime të ndjekura nga procesi i verifikimit ndaj nuk duhet të aplikohet.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, në germen “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Robert Kote, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 19.12.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ

Kryesues

(kundër)

Valbona SANXHAKTARI

Relatore

Genta TAFA (BUNGO)

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Jonida Vrana